



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.122**

**2 shtator**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.642, datë 28.7.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike në bashkinë e Çorovodës.....	6525
Vendim i KM nr.643, datë 3.8.2010	Për zhvendosjen e disa mjeteve detare luftarake, të fundosura dhe të dala jashtë përdorimit dhe armatimit të Forcave të Armatosura, të dorëzuara Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me qëllim ushtrimin e veprimtarive të zhytjeve çlodhëse .....	6526
Vendim i KM nr.644, datë 16.6.2010	Për përcaktimin e procedurës dhe të masës së trajtimit të veçantë financiar të pilotëve e të teknikëve fluturues të Njësisë së Transportit Mjekësor me Helikopter, në pension	6535
Vendim i KM nr.647, datë 28.7.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Dhërmi – Vuno .....	6536
Vendim i KM nr.648, datë 28.7.2010	Për Avokatin e Tatimpaguesit .....	6537
Vendim i KM nr.651, datë 5.8.2010	Për lejimin e Kryeministrisë, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit me objekt “Abonimi i shtypit të brendshëm”, për nevojat e veta .....	6539
Vendim i KM nr.652, datë 6.8.2010	Për një shtesë fondi, në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, për pagesën e detyrimeve për energji elektrike të shoqërive të ujësjellësve	6540

Vendim i KM nr.653, datë 28.7.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.172, datë 10.3.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të shërbimit të anijeve detare dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë “Anijet e shërbimit detar” sh.a. ....	6542
Vendim i KM nr.654, datë 28.7.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.20, datë 13.1.2010 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e Komisionit të Ndihmës Shtetërore” .....	6542
Vendim i KM nr.657, datë 4.8.2010	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar .....	6543
Vendim i KM nr.658, datë 4.8.2010	Për dhënie fondi shtesë, bashkisë Bulqizë, për rikonstruksionin e godinës së Qendrës së Kulturës .....	6544
Vendim i KM nr.659, datë 4.8.2010	Për dhënie fondi në buxhetin e vitit 2010, komunës Kukur të qarkut të Elbasanit, si ndihmë për familjet, të cilave u janë dëmtuar banesat nga rrëshqitja masive e tokës .....	6544
Vendim i KM nr.660, datë 4.8.2010	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.....	6545
Vendim i KM nr.661, datë 4.8.2010	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Poroçan të qarkut të Elbasanit	6546
Vendim i KM nr.662, datë 4.8.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Mbrostar të qarkut të Fierit .....	6547
Vendim i KM nr.700, datë 13.8.2010	Për miratimin e pagesave për ushtrimin e gjuetisë .....	6548

**VENDIM**  
**Nr.642, datë 28.7.2010**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE  
PUBLIKE NË BASHKINË E ÇOROVODËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike në bashkinë e Çorovodës.
  2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Çorovodës.
  3. Pasuritë, në sipërfaqen prej 2000 (dy mijë) m<sup>2</sup> tokë arë, pronë private që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  4. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Çorovodës, planifikuar në buxhetin e saj.
  5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
  6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Çorovodës.
  7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Çorovodës, për realizimin e këtij projekti.
  8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 2000 (dy mijë) m<sup>2</sup> tokë arë, shpronësuar në favor të bashkisë së Çorovodës, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
  9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Çorovodës për zbatimin të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË  
SHPRONËSOHEN PËR “ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT TË  
ÇOROVODËS” NË BASHKINË E ÇOROVODËS**

<b>Nr.</b>	<b>Emër, mbiemër</b>	<b>Sip.arë m<sup>2</sup></b>	<b>Çmimi lekë/m<sup>2</sup></b>	<b>Vlera lekë</b>	<b>Dokumenti i pronësisë</b>	<b>Zona kadastrale</b>
1	Selam Koprëncka	1000	700	700000	Certifikatë pronësie	1420
2	Hektor Koprëncka	1000	<b>700</b>	700000	Certifikatë pronësie	1420
	<b>Totali</b>	<b>2000</b>		<b>1400000</b>		

**VENDIM**  
**Nr.643, datë 3.8.2010**

**PËR ZHVENDOSJEN E DISA MJETEVE DETARE LUFTARAKE, TË FUNDOSURA DHE TË DALA JASHTË PËRDORIMIT DHE ARMATIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË DORËZUARA MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, ME QËLLIM USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE TË ZHYTJEVE ÇLODHËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 32 e 401 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Zhvendosjen e disa mjeteve detare luftarake, të fundosura dhe të dala jashtë përdorimit dhe armatimit të Forcave të Armatosura, të dorëzuara Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në zonat e përcaktuara sipas hartave dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim ushtrimin e veprimtarive zhytëse çlodhëse.

2. Të dhënat identifikuese të mjeteve detare luftarake janë përcaktuar në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Rregullat e hollësishme për procedurat e ushtrimit të zhytjeve çlodhëse përcaktohen me urdhër të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**SHTOJCA NR.1**

**TË DHËNAT IDENTIFIKUESE TË MJETEVE DETARE LUFTARAKE TË DALA JASHTË PËRDORIMIT, TË PARASHIKUARA NË PIKËN 2 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

1. Nëndetësja 332 Tufani
2. Katër silurues 302 Patrioti
3. Katër silurues 303 Delfini
4. Katër silurues 307 Luftëtari
5. Katër silurues 309 Heroi
6. Katër silurues 310 Trimi
7. Rimork.detar 253 M.Ulqinaku





# FORCA DETARE FLOTILJA DETARE JUGORE

Gjiu i  
Kasolles

Gjiu i  
Vorrezave

Baza Detare  
Sarande

Porti i  
Sarandes

Gjiu i  
Pasqyrave

Gjiu i  
Tetranisit  
(Ksamil)



Data SIO, NOAA, U.S. Navy, NGA, GEBCO  
Imagery © 2010 DigitalGlobe  
Imagery Data Aug 21, 2007, Nov 24, 2007  
30.4624 00° N 10.6846 33° E Elev. 311.65 30 m






**FORÇA DETARE  
FLOTILJA DETARE JUGORE**

## GJIU I PASQYRAVE


Jashtë çdo komunikimi tokësor





# FORÇA DETARE FLOTILJA DETARE JUGORE

## GJIU I TETRANISIT



Vaskat

Rajoni i  
mbytyes

Ksamili

Data e dhënë nga Google Maps, © 2003-2007  
Imazhi © 2007 Google, Inc.  
30°46'37" 00" N, 20°52'03" 11" E

Imazhi © 2003-2007 Google, Inc.








# FORCA DETARE FLOTILJA DETARE JUGORE


## GJIU I TETRANISIT





# FORCA DETARE FLOTILJA DETARE JUGORE


## GJIU I TETRANISIT





**FORÇA DETARE  
FLOTILJA DETARE JUGORE**

**GJIU I TETRANISIT  
PAMJA NGA DETI**





**FORCA DETARE  
FLOTILJA DETARE JUGORE**

**GJIU I TETRANISIT**

**PAMJA NGA TOKA**



**VENDIM**  
**Nr.644, datë 16.6.2010**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE TË MASËS SË TRAJTIMIT TË VEÇANTË  
FINANCIAR TË PILOTËVE E TË TEKNIKËVE FLUTURUES TË NJËSISË SË  
TRANSPORTIT MJEKËSOR ME HELIKOPTER, NË PENSION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 8 të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Piloti/tekniku i interesuar, për efekt të llogaritjes, caktimit dhe pagesës së shtesës mbi pension, si trajtim i veçantë financiar, të tërheqë nga dega e sigurimeve shoqërore dy formularë kërkesë për përfitim, të cilat i dorëzon, përkatësisht, në Njësinë e Transportit Mjekësor me Helikopter, ku ka punuar deri në ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, dhe në degën e sigurimeve shoqërore ku ka vendbanimin.

Dokumentacioni i nevojshëm për përfitimin e trajtimit të veçantë të përgatitet nga Njësia e Transportit Mjekësor me Helikopter dhe t'i dërgohet Ministrisë së Shëndetësisë, e cila pasi e shqyrton, ia dërgon degëve përkatëse të sigurimeve shoqërore.

2. Për llogaritjen e trajtimit financiar të merret si bazë paga referuese, e njehsuar me pagën referuese të funksionit organik të pilotit ose të teknikut aktiv në Njësinë e Transportit Mjekësor me Helikopter, në të njëjtën detyrë me përfituesin, në çastin e lindjes të së drejtës për këtë trajtim financiar.

Paga referuese për përfituesin përfshin:

- a) Pagën e grupit;
- b) Shtesën për vjetërsi;
- c) Shtesën për kualifikim;
- ç) Shtesën për pozicion;
- d) Shtesën për kushte pune;
- dh) Shtesën e fluturimeve vjetore.

3. Për efekt të vendosjes në kushtet e përfitimeve, sipas nenit 4 të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar, personat, që kanë fluturuar me avionë me helikë, barazohen me personat që kanë fluturuar me helikopterë.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për hartimin e udhëzuesit dhe të dokumentacionit tip për zbatimin e këtij vendimi.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i viteve përkatëse, të miratuara për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.10135, datë 11.5.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.647, datë 28.7.2010**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT  
RRUGOR DHËRMI - VUNO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Dhërmi - Vuno.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen kullotë 2531 m<sup>2</sup>, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 507 465 (pesëqind e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekësh.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 270 000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera totale e shpronësimit prej 507 465 (pesëqind e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
6. Shpronësimi të fillojë më 1.8.2010 dhe të përfundojë më 30.10.2010.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
8. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP Vlorë (bashkëpronësi)”, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP Vlorë (bashkëpronësi)”, pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë.
10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
11. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRASPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE  
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI SEGMENTIT  
RRUGOR DHËRMI-VUNO

Nr.	Pronari	Zk	Nr. regjistri hipotekor	Kullotë			Shënime
	Emri			Sip.m <sup>2</sup>	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Vlera lekë	
	Guliem Petro Trola Vasilika Petro Gjini (Trola) Liri Petro Kora (Trola) Spiro Petro Trola Kristina Petro Trola Polikseni Trola Edmond Foto Trola Aleksandra Foto Trola Agron Foto Trola	3844	52	2531	200.5	507465.5	Konfirmuar nga ZRPP Vlorë Bashkëpronësi
	<b>Totali</b>			<b>2531</b>		<b>507465.5</b>	

**VENDIM**  
**Nr.648, datë 28.7.2010**

**PËR AVOKATIN E TATIMPAGUESIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 105/2 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Ky vendim ka për qëllim të rregullojë strukturën, autoritetin, funksionet, bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e Avokatit të Tatimpaguesve me strukturat e tjera brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe me palët e treta.

**1. Struktura**

1.1 Avokati i Tatimpaguesit është i organizuar në nivel drejtorie brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

1.2 Avokati i Tatimpaguesit emërohet nga Ministri i Financave, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Ai varet drejtpërsëdrejti nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

1.3 Paga e Avokatit të Tatimpaguesit është në nivel të njëjtë me pagën e drejtorëve të drejtorive në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

1.4 Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit ka në përbërje Avokatin e Tatimpaguesit dhe 3 (tre) punonjës.

**2. Roli i avokatit të tatimpaguesve**

2.1 Në zbatim të legjislacionit tatimor, për të siguruar më shumë transparencë, përgjegjshmëri dhe integritet nga ana e administratës tatimore, Avokati i Tatimpaguesit garanton mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të tatimpaguesve. Avokati i Tatimpaguesve, gjithashtu, ndihmon në përhapjen e informacionit për të drejtat e tatimpaguesve dhe edukimin e tyre.

2.2 Avokati i Tatimpaguesit investigon dhe ndërhyr për zgjidhjen e problemeve që u referohen ankesave të tatimpaguesve pranë drejtorive rajonale tatimore dhe/ose drejtorive funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

2.3 Si anëtar i stafit ekzekutiv të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Avokati i Tatimpaguesit merr pjesë duke kontribuar në zbatimin e balancave të duhura ndërmjet barrës administrative të vendosur ndaj tatimpaguesve dhe përmbushjes së detyrimeve sipas legjislacionit tatimor.

2.4 Avokati i Tatimpaguesit analizon ankesat e paraqitura dhe rezultatet e shqyrtimeve dhe raporton te Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe te Ministri i Financave, duke bërë propozime për përmirësime të mëtejshme procedurale e ligjore.

### 3. Autoriteti dhe funksionet

3.1 Avokati i Tatimpaguesit monitoron procedurat administrative tatimore me synim mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesve.

3.2 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritetin të ngarkojë drejtoritë rajonale tatimore për evidentimin e informacionit për shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve.

3.3 Avokati i Tatimpaguesit ka akses të sigurojë informacionin dhe dokumentacionin e administruar nga administrata tatimore, që lidhet me çështjet që ai shqyrton.

3.4 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritetin t'i kërkojë shqyrtimin e një praktike drejtorisë rajonale tatimore për evidentimin e informacioneve dhe për shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve të veçantë.

3.5 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritetin të bëjë kërkesë për shqyrtimin e një procedure drejtuar drejtorive funksionale.

3.6 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritet të rekomandojë përmirësimin e procedurave tatimore dhe, po të jetë rasti, edhe ndryshime në legjislacionin tatimor apo Kodin e Etikës së Administratës Tatimore.

3.7 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritetin të referojë raste të veçanta te Drejtoria e Kontrollit Tatimor ose Drejtoria e Investigimit Tatimor, nëse informacioni apo dokumentacioni lidhur me një ankesë konkrete nga tatimpaguesit tregon se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të kontrollit apo investigimit administrativ tatimor.

3.8 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritetin të referojë raste të veçanta te Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm ose Drejtoria e Investigimit të Brendshëm, nëse informacionet e administruara prej tij, në mënyrë të përsëritur, u referohen sjelljeve të papërshtatshme të punonjësve/ inspektorëve të caktuar apo keqpërdorimit të procedurave, sistemeve dhe autoritetit zyrtar prej tyre, duke treguar se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të kontrollit apo investigimit të brendshëm për ata punonjës të administratës tatimore apo procedurat e sistemet përkatëse.

3.9 Opinione dhe rekomandimet e nxjerra nga Avokati i Tatimpaguesit duhet të trajtohen me përgjegjësi nga hallkat përkatëse të administratës tatimore.

3.10 Në rast mungese bashkëpunimi nga ana e punonjësve të administratës tatimore, Avokati i Tatimpaguesit njofton menjëherë dhe kërkon mbështetjen e eprorëve të atyre punonjësve, përkatësisht drejtorit rajonal apo drejtorit funksional.

3.11 Në rast se Avokati i Tatimpaguesit dhe një drejtor rajonal nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një kërkesë për shqyrtim, Avokati i Tatimpaguesit dhe drejtori rajonal do t'ia paraqesin rastin zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm Territorial që mbulon drejtorinë rajonale në fjalë. Nëse Avokati i Tatimpaguesit dhe një drejtor funksional në DPT nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një kërkesë për shqyrtim, Avokati i Tatimpaguesit dhe drejtori funksional do t'ia paraqesin rastin zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm që mbulon drejtorinë funksionale përkatëse.

3.12 Nëse Avokati i Tatimpaguesit dhe një zëvendësdrejtor i përgjithshëm nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një rasti apo procedure, të dy së bashku do ta paraqesin problemin te drejtori i Përgjithshëm, i cili do të marrë vendimin përfundimtar për rastin në fjalë.

3.13 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritetin të kërkojë marrjen e masave disiplinore për punonjësit në drejtoritë rajonale tatimore/drejtoritë funksionale pranë DPT-së, të cilët, nga analizimi i rasteve të shqyrtuara prej tij, rezulton se nuk respektojnë procedurat apo i shkelin ato me dashje.

3.14 Avokati i Tatimpaguesit nuk ka autoritet të përcaktojë detyrime tatimore ose të



ndërhyjë në një rast që është në proces apelimi. Avokati i Tatimpaguesit nuk ka autoritet të ndërhyjë në një rast që është në proces investigimi të brendshëm (antikorrupsioni) apo në proces investigimi kriminal tatimor. Avokati i Tatimpaguesit është i autorizuar të mos japë asistencë ndaj çdo tatimpaguesi, ankimi i të cilit duket i pabazuar dhe është paraqitur me qëllim që të vonojë veprimet e duhura të administratës tatimore.

4. Marrëdhëniet me strukturat e tjera të administratës tatimore dhe me palët e treta

4.1 Për përmbushjen e misionit e të detyrave dhe për të ushtruar normalisht autoritetin që i jep ligji dhe dispozitat nënligjore përkatëse, Avokati i Tatimpaguesit bashkëpunon me të gjitha drejtoritë rajonale e funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

4.2 Duke qenë se raporton direkt te Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, Avokati i Tatimpaguesit mund të kontaktojë drejtpërdrejt personat përgjegjës në çdo sektor apo drejtori në drejtoritë rajonale e funksionale, pa pasur nevojë për ndonjë miratim paraprak nga eprori hierarkik i punonjësit që kontaktohet.

4.3 Avokati i Tatimpaguesit, në funksion të ushtrimit të detyrave të tij, mund të kontaktojë drejtpërdrejt institucione të tjera shtetërore apo private, organizatat e biznesit apo profesionale, përfaqësuese të tatimpaguesve.

4.4 Avokati i Tatimpaguesit është anëtar i përhershëm i Këshillit Konsultativ Tatimor dhe merr pjesë edhe në forumet dhe organizimet e biznesit për çështje që lidhen me aspektet e administrimit tatimor dhe mund të iniciojë takime me bizneset, për diskutimin e situatave që kanë të bëjnë me probleme të procedurave të administrimit të tatimeve.

5. Raportimi

5.1 Avokati i Tatimpaguesit raporton me shkrim, periodikisht, një herë në muaj, te drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe një herë në tre muaj te Ministri i Financave.

5.2 Në rastet kur e gjykon të arsyeshme, Avokati i Tatimpaguesit ka të drejtë të kërkojë të raportojë te Ministri i Financave ose drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve për situata apo çështje të veçanta, përveç raportimit periodik.

5.3 Raportimi duhet të përfshijë të dhëna statistikore lidhur me ankesat e paraqitura dhe rastet e shqyrtuara, gjetjet, rezultatet e arritura, si edhe konkluzione e rekomandime.

Për periudhën 1 qershor 2010 – 31 dhjetor 2010, burimet financiare për Avokatin e Tatimpaguesit do të përballohen nga Ministria e Financave brenda buxhetit ekzistues të këtij viti.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.651, datë 5.8.2010**

**PËR LEJIMIN E KRYEMINISTRISË, SI AUTORITET KONTRAKTOR, PËR KRYERJEN  
E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT ME OBJEKT “ABONIMI I SHTYPIT TË  
BRENDSHËM”, PËR NEVOJAT E VETA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Kryeministrit, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit, me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti, me objekt “Abonimi i shtypit të brendshëm”, për nevojat e veta, si dhe për të lidhur kontratën përkatëse.

2. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

VENDIM  
Nr.652, datë 6.8.2010

**PËR NJË SHITESË FONDI, NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË  
E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR PAGESËN E DETYRIMEVE PËR  
ENERGJI ELEKTRIKE TË SHOQËRIVE TË UJËSJELLËSVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe neneve 13 e 16 të ligjit nr.10 190, datë 4.12.2009 “Për buxhetin e viti 2010”, dhe propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, në programin “Ujësjellës-Kanalizime”, shpenzime korrente, t’i shtohet fondi prej 1 730 000 000 (një miliard e shtatëqind e tridhjetë milionë ) lekësh, për pagesën e detyrimeve për energji elektrike, të shoqërive të ujësjellësve, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky fond të përballohet si më poshtë vijon:

- 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë nga pakësimi në programin “Strehimi dhe urbanistika”, shpenzime korente, i miratuar në buxhetin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

- 1 200 000 000 (një miliard e dyqind milionë) lekë nga fondi i kontigjencës i buxhetit të shtetit.

- 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Për pagesën e detyrimeve për energji elektrike, të shoqërive të ujësjellësve, sipas lidhjes 1 të këtij vendimi, të përdoret dhe fondi i padetajuar prej 340 000 000 (treqind e dyzet milionë) lekësh, nga zëri subvencione për ujësjellës, miratuar në buxhetin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

4. Shuma e paguar për detyrimet e energjisë elektrike të shoqërive të ujësjellësve, që i korrespondon detyrimeve për energji elektrike të këtyre shoqërive, të zbritet nga transfertat e pakushtëzuara të vitit 2010, të njësive të qeverisjeve vendore, ku këto shoqëri ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

TABELA SIPAS AKT RAKORDIMEVE NDËRMJET OSSH DHE SH.A.UK	
Emërtimi i shoqërisë	Detyrimet progresive për
	energjinë deri 30.6.2010 në 000/lekë
Ujësjiellës Sarandë	32 535
Ujësjiellësi Vau i Dejës	6 306
Ujësjiellësi Tropojë	27 692
Ujësjiellësi Krujë	157
Ujësjiellësi Berat	433
Ujësjiellësi Lezhë	63 836
Ujësjiellësi Elbasan Qytet	78 489
Ujësjiellësi Shkodër Qytet	185 040
Ujësjiellësi Përmet	203
Ujësjiellësi Vlorë	228 327
Ujësjiellësi Durrës	808 480
Ujësjiellësi Novosel	21 805
Ujësjiellësi Shkodër Fshat	24 986
Ujësjiellësi Elbasan Fshat	91 617
Ujësjiellësi Korçë Fshat	18 668
Ujësjiellësi Lushnjë Fshat	8 554
Ujësjiellësi Gjirokastër Fshat	115
Ujësjiellësi Bilisht	5 697
Ujësjiellësi Mirditë	8 088
Ujësjiellësi Rrogozhinë	5 462
Ujësjiellësi Fier	79 962
Ujësjiellësi Fushë-Krujë	10 378
Ujësjiellësi Kavajë	22 564
Ujësjiellësi Mallakastër	3 598
Ujësjiellësi Gjirokastër Qytet	1 432
Ujësjiellësi Lushnjë Qytet	28 497
Ujësjiellësi Libohovë	301
Ujësjiellësi Selenicë	8 901
Ujësjiellësi Peqin	10 860
Ujësjiellësi Gramsh	104
Ujësjiellësi Kuçovë	18 148
Ujësjiellësi Bulqizë	17 148
Ujësjiellësi Tepelenë	25 607
Ujësjiellësi Poliçan	4 878
Ujësjiellësi Has	12 378
Ujësjiellësi Çorovodë	4 728
Ujësjiellësi Kukës	9 439
Ujësjiellësi Kurbin	62 751
Ujësjiellësi Delvinë	9 493
Ujësjiellësi Ura Vajgurore	9 206
Ujësjiellësi Krastë	23
Ujësjiellësi Patos	88 871
Ujësjiellësi Këlcyrë	5 814
Ujësjiellësi Orikum	500
Ujësjiellësi Kamëz	17 929
<b>Shuma totale</b>	<b>2 070 000</b>

**VENDIM**  
**Nr.653, datë 28.7.2010**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.172, DATË 10.3.2010 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN  
ME KONCESION TË SHËRBIMIT TË ANIJEVE DETARE DHE MIRATIMIN E BONUSIT  
NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË  
“ANIJET E SHËRBIMIT DETAR” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, pikat 1 e 3 dhe nenit 23, pika 3, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.172, datë 10.3.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënie me koncesion të disa shërbimeve detare”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të shërbimeve detare, është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

Shërbimet që do të jepen me koncesion janë:

a) Kryerja e shërbimit të rimorkimit të anijeve gjatë operacionit të futjes e daljes nëpër porte, akostimit në kalatat e porteve;

b) Shërbimi i transportit të grupeve të praktikës së autoriteteve portuale gjatë marrjes së praktikave të lira në rada;

c) Transportimi i ekuipazheve të anijeve nga rada në port dhe anasjelltas;

ç) Operacionet e ngarkim-shkarkimit të peshave të rënda në det.”.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.654, datë 28.7.2010**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 20, DATË 13.1.2010 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në përbërjen e Komisionit të Ndhmës Shtetërore, të përcaktuar në pikën 1 të vendimit nr. 20, datë 13.1.2010 të Këshillit të Ministrave, në vend të z. Gjergj Thomai, anëtar, caktohet z. Besjan Pesha, anëtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.657, datë 4.8.2010**

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.405, DATË 8.1.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR DHE RRJETIT RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1, rrjetit rrugor kombëtar i hiqen akset rrugore, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në tabelën “Inventari i rrugëve rurale, rajonale e komunale”, të përmendur në pikën 4/1, të shtohen segmentet rrugore, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Brendshme, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

**SEGMENTET RRUGORE QË DO TË KALOJNË NGA INVENTARI I RRUGËVE NACIONALE NË INVENTARIN E RRUGËVE RAJONALE RURALE**

1	Aksi rrugor Burrel- Koms	7 km	Rruga nr.37
2	Aksi rrugor Këlcyrë – Ballaban – Kufi Berat	35 km	pjesë nga rruga nr.74
3	Aksi Leskovik – Sarandopor	11 km	Rruga nr.65
4	Aksi rrugor Rrëshen – Prosek – Kurbnesh – Lurë	56 km	Rruga nr.34
5	Aksi rrugor Kuç – Borsh (pjesë e Kote – Kuç – Borsh)	22 km	
6	Aksi rrugor Fushë Arrëz – Iballë	60 km	
7	Krujë – Qafshatë	26 km	pjesë nga rruga nr.38
8	Gramsh – Grabovë – Maliq (vetëm për një lot 38.8 km)	38.8 km	pjesë nga rruga nr.71
9	Fier – Kraps – Lalar	10 km	
10	Libonik – Rrëmbec – Plase	13 km	Rruga nr.101
11	Kukës – Shishtavec	31 km	Rruga nr.26
12	Hani i Hotit – Tamarë	31 km	Rruga nr.20
13	Aeroport – Kolesian – Domaj	12 km	pjesë nga rruga nr.31
14	Bogë - Theth	27 km	pjesë nga rruga nr.21

**VENDIM**  
**Nr.658, datë 4.8.2010**

**PËR DHËNIE FONDI SHITESË, BASHKISË BULQIZË, PËR RIKONSTRUKSIONIN E  
GODINËS SË QENDRËS SË KULTURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Bashkisë Bulqizë, qarku Dibër, në buxhetin e vitit 2010, t’i jepet fondi shtesë në shumën prej 6 999 974 (gjashtë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekësh, për zbatimin e projektit të rikonstruksionit të Qendrës së Kulturës, Bulqizë.
  2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
  3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, bashkia Bulqizë dhe institucioni i prefektit të qarkut Dibër, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.659, datë 4.8.2010**

**PËR DHËNIE FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, KOMUNËS KUKUR TË QARKUT TË  
ELBASANIT, SI NDIHMË PËR FAMILJET, TË CILAVE U JANË DËMTUAR BANESAT  
NGA RRËSHQITJA MASIVE E TOKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010” dhe të neneve 31, pika 1 e 32, shkronja “a”, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Komunës Kukur, të qarkut të Elbasanit, në buxhetin e vitit 2010, t’i jepet fondi prej 20 097 000 (njëzet milionë e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekësh, si ndihmë për familjet e kësaj komune, të cilave u janë dëmtuar banesat nga rrëshqitja masive e tokës.
  2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
  3. Fondi i dhënë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, t’u shpërndahet familjeve, sipas listës me emrat e kryefamiljarëve, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
  4. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, prefekti i qarkut Elbasan, si dhe komuna Kukur për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**LISTA ME EMRAT E KRYEFAMILJARËVE TË KOMUNËS KUKUR QARKU ELBASAN, TË  
CILËT PËRFITOJNË NDIHMË FINANCIARE, SIPAS KËTIJ VENDIMI**

<b>Nr.</b>	<b>Emër, atësi, mbiemër</b>	<b>Ndihma 000/lekë</b>
1	Izet Shefit Dakaraja	930
2	Ferdinan Nefail Hysa	1016
3	Laver Hetem Meçi	1048
4	Shkëlqim Muharrem Rika	1024
5	Sokol Estref Rika	943
6	Luan Ibrahim Kokla	2103
7	Besnik Ibrahim Kokla	1479
8	Festim Ibrahim Kokla	619
9	Qamil Zaim Hysa	978
10	Agim Zaim Hysa	875
11	Idaet Telha Hysa	960
12	Rexhep Telha Hysa	760
13	Vesel Telha Hysa	760
14	Fazlli Sabri Hysa	1017
15	Shirgjon Mehmet Rika	563
16	Samit Belul Rika	903
17	Afrim Ramazan Rika	903
18	Feti Et'hem Rika	951
19	Bedri Tafil Rika	1017
20	Sejat Bajram Kishta	1248
	<b>Shuma</b>	<b>20097</b>

**VENDIM  
Nr.660, datë 4.8.2010**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME,  
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Lista që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 7 (shtatë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 26 (njëzet e gjashtë).

2. Ngarkohen Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI  
Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.661, datë 4.8.2010**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS POROÇAN TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Poroçan, të qarkut të Elbasanit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij

Lista e inventarit me 88 (tetëdhjetë e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 634 (gjashtëqind e tridhjetë e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Poroçan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Komuna Poroçan

Lidhja nr.1

<b>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</b>	<b>Fusha e përdorimit të pronës</b>	<b>Lloji i transferimit</b>
1-5	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
6-8	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
9-19	Varrezat publike	Në pronësi
20-33	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillimin ekonomik.	Në pronësi
34-76	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
77,78,80,82	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
79,81,83,84	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
516-570	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi



**VENDIM**  
**Nr.662, datë 4.8.2010**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS MBROSTAR TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Mbrostar të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Mbrostar të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.184, datë 19.2.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Mbrostar të qarkut të Fierit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Mbrostar për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Komuna Mbrostar

Lidhja nr.1

<b>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</b>	<b>Fusha e përdorimit të pronës</b>	<b>Lloji i transferimit</b>
38-48	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
49	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
74-81	Varrezat publike	Në pronësi
82-94	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore (pasuritë me nr.83,85,92, ndodhen brenda shkollës 9-vjeçare; pasuritë nr.88,89 ndodhen brenda truallit të shkollës së mesme).	Në pronësi
95-100	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik (pasuritë me nr.96,99 ndodhen brenda shkollës, pasuria me nr.100 ndodhet brenda ndërtesës së kopshtit).	Në pronësi
101-105	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
106-115	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
118,126,136,140,143-145,150,152,157,159,161, 168,170,173,178,181,182, 184,185	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproductive).	Në pronësi
171,172,176,179,183	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
186-199	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

**VENDIM**  
**Nr.700, datë 13.8.2010**

**PËR MIRATIMIN E PAGESAVE PËR USHTRIMIN E GJUETISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 44 të ligjit nr.10253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e pagesave për ushtrimin e veprimtarisë së gjuetisë në Republikën e Shqipërisë, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  2. Pagesat, sipas individëve të llojeve objekt gjuetie, janë sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  3. Pagesa për ushtrimin e gjuetisë bëhet në çastin e marrjes së lejes, duke paraqitur mandatpagesën e derdhjes në bankë.
  4. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**Shtojca 1. PAGESAT PËR USHTRIMIN E GJUETISË NË SHQIPËRI**

Për të gjithë vendin	1 vit	10 000 lekë
Për një qark	1 vit	2000 lekë
Për të gjithë vendin	5 vjet	40 000 lekë
Për një qark	5 vjet	8000 lekë

**Shtojca 2. PAGESA PËR ÇDO INDIVID TË LLOJEVE OBJEKT GJUETIE**

<b>Lloji</b>	<b>Çmimi (lekë/krerë)</b>
Lepur i egër (Lepus europaeus)	5500
Dhelpër (Vulpes vulpes)	2000
Thëllëzë mali (Alectoris graeca)	4500
Kryekuqe e madhe (Anas Penelope)	1300
Kuqja (Anas platyrhynchos)	1300
Grilla (Anas crecca)	1300
Rosa e zezë (Anas stepera)	1300
Bishtëgjela (Anas acuta)	1300
Sqepluga (Anas clypeata)	1300
Marsatorja (Anas querquedula)	1300
Turtull (Streptopelia turtur)	500
Shkurte (Coturnix coturnix)	500
Shapkë uji (Gallinago gallinago)	600
Bajze (Fulica atra)	600
Pëllumb i egër (Columba livia)	800
Laureshë (Alauda arvensis)	100
Shapkë (Scolopax rusticola)	1200

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE .....	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË .....	512 lekë

Hyri në shtyp më 31.8.2010

Doli nga shtypi më 2.9.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2010

Çmimi 28 lekë